



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1112/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë-dega në Vushtrri, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë-dega në Vushtrri, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet politike Mbështetësit dhe kandidatet e tyre, për raundin e Dytë për Zgjedhjet Lokale, të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e parregullt ankesa Anr.1112/2021 e datës 12.11.2021, e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Dega në Vushtrri, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Dega në Vushtrri, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet politike Mbështetësit dhe kandidatet e tyre, për raundin e Dytë për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtrri, me datën 10.11.2021, nëpërmjet Postës së Kosovës ka parashtruar një ankesë e cila është pranuar në PZAP me datën 12.11.2021, në të cilën pretendon se kryetari i Komunës së Vushtrrisë njëkohësisht kandidat për kryetar të kësaj komune në zgjedhjet lokale 2021 Xhafer Tahiri duke keqpërdoruar postin publik të tij dhe infrastrukturën komunale nga zyra e komunës, propagandon dhe bene fushatë elektorale duke bërë thirrje për pjesëmarrje në një tubim elektorale të organizuar nga subjekti i tij politik LDK. Parashtruesi i ankesës thekson se kjo shkelje e Kodit të Mirësjelljes ka ndodhur me datën 08.11.2021 ku i njëjti përmes një video mesazhi fton elektoratin e LDK-së për pjesëmarrje në tubim, veprime këto sipas parashtruesit të ankesës janë shkelje e nenit 6.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Andaj i njëjti kërkon që konform dispozitave ndëshkimore të gjobitet subjekti politik LDK gega në Vushtrri.

Paneli, pasi që vlerësoj rregullsinë e ankesës, gjeti se e njëjta është **parregullta**, për këto arsye:

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e paraqitura, nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtrri, kundër subjektit politik LDK dega në Vushtrri, është e parregullt, pasi që ankesa e paraqitur në PZAP, nuk është e nënshkruara nga ankuesi, andaj ankesa e paraqitur nuk i plotëson kushtet ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari. Në rastet kur ankuesi/ja është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare apo nga çfarëdo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i ati personi juridik siç është përcaktuar në rastet ku kjo është e mundshme në çfarëdo dispozite ligjore ne fuqi.*

Prandaj Paneli, me rastin e shqyrtimit të rregullsisë së ankesës, gjeti se e njëjta është e parregullt sepse nuk është nënshkruar nga ankuesi, dhe se e njëjta nuk i plotëson kriteret sipas nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, andaj paneli nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1112/2021 më datën 15.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 24 orëve, nga momenti i pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*